



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 795/ 2 Prot.

Tiranë, më 26. 06.2026

V E N D I M

Nr. 122, Datë 26.05. 2026

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar¹, mori në shqyrtim ankesën nr.101 Regj., datë 23.04.2026, të z. A. K., kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*përgjegjësisë prindërore*”, “*gjendjes familjare*”, “*gjendjes martesore*” dhe “*gjendjes civile*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit ankuesi, ka parashtruar si vijon: *Ankuesi A. K., pretendon se, pas zgjidhjes së martesës me R. D., dhe lënies së fëmijës për rritje e edukim nënës, atij i është penguar në mënyrë të vazhdueshme ushtrimi i përgjegjësisë prindërore. Sipas tij, prej vitit 2019 ish-bashkëshortja ka krijuar pengesa të vazhdueshme për kontaktet me vajzën, duke mos lejuar takimet, komunikimin dhe informimin për jetën e saj. Ai pretendon se kjo situatë është përkeqësuar edhe nga institucionet arsimore, konkretisht Shkolla 9-vjeçare “Vëllazërimi”, ZVA Kamëz, DRAP Tiranë, AKAP dhe MAS, të cilat i kanë ndërprerë aksesin në sistemin SMIP menjëherë pasi vendimi i divorcit mori formë të prerë, duke e lënë pa informacion mbi notat, mungesat dhe ecurinë shkollore të vajzës së tij.*

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Sipas ankuesit, institucionet arsimore kanë tejkaluar kompetencat e tyre duke e trajtuar atë si prind pa të drejta prindërore vetëm pse është i divorcuar dhe fëmija jeton me nënën. Ai pretendon se asnjë vendim gjykatë nuk ia kufizon të drejtën për t'u informuar mbi arsimimin dhe mirëqenien e fëmijës apo për të marrë pjesë në jetën shkollore të saj. Për këtë arsye, ankuesi vlerëson se ndërprerja e aksesit në SMIP, mosdhënia e informacionit dhe mosreagimi i institucioneve ndaj ankesave të tij përbëjnë trajtim të pabarabartë dhe diskriminim për shkak të gjendjes familjare/civile si prind i divorcuar, duke cenuar si të drejtat e tij prindërore ashtu edhe interesin më të lartë të fëmijës.

Masat që kërkohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

1. Pranimin e ankesës.
2. Konstatimin e diskriminimit ndaj A. K., për shkak të përgjegjësisë prindërore, gjendjes familjare, gjendjes martesore, gjendjes civile nga DRAP Tiranë.
3. Urdhërimin e DRAP Tiranë për ndalimin e menjëhershëm të diskriminimit ndaj z. A. K.
4. Urdhërimin e DRAP Tiranë për marrjen e masave të menjëhershme për të garantuar dhe rikthyer aksesin e A. K., në SMIP, si e drejtë legjitime për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së tij E. K.
5. Urdhërimin e DRAP Tiranë për të lejuar A. K., për të ushtruar i qetë dhe pa pengesa përgjegjësinë prindërore ndaj fëmijës së tij E. K., lidhur me arsimin.
6. Marrjen e çdo mase tjetër të përshtatshme e të nevojshme në bazë të ligjit që çmohet për ndalimin e diskriminimit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës nr. 101 Regj., datë 23.04.2026, paraqitur kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “përgjegjësisë prindërore”, “gjendjes familjare”, “gjendjes martesore” dhe “gjendjes civile”, u vlerësua e nevojshme administrimi i informacionit dhe dokumentacionit shtesë për sqarimin e plotë të rrethanave të çështjes.

Në këtë kuadër, me shkresën nr. 795/2 prot., datë 07.05.2026, Komisioneri iu drejtua ankuesit duke i kërkuar të paraqesë informacion mbi datën dhe mënyrën e komunikimit me DRAP Tiranë lidhur me çështjen objekt ankesë, kopje të komunikimeve të zhvilluara me këtë institucion, përfshirë kërkesat, ankesat, email-et dhe çdo komunikim tjetër shkresor ose elektronik që lidhet me ndërprerjen e aksesit në sistemin SMIP dhe pretendimet për pengim të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, si dhe informacion mbi çdo përgjigje zyrtare të kthyer nga DRAP Tiranë ndaj kërkesave apo ankesave të paraqitura.

Në lidhje me kërkesat e përcaktuara në shkresën nr. 795/2 prot., datë 07.05.2026 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankuesi nuk depozitoi pranë Komisionerit asnjë informacion apo dokumentacion shtesë brenda afatit të përcaktuar, megjithëse nga të dhënat e administruara rezultoi se shkresa i ishte njoftuar rregullisht nëpërmjet shërbimit postar dhe ishte marrë dijeni prej tij.

Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

Bazuar në nenin 33, pika 1, të LMD, përcaktohet se: “1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”

Bazuar në nenin 32, pika 3, të LMD, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Bazuar në nenin 3, pika 7, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;”

Bazuar në nenin 3, pika 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: “8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës dhe mbështetur në faktet dhe pretendimet e parashtruara nga ankuesit, Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç” të LMD, ku përcaktohet se: “:“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar”, ankesa objekt shqyrtimi nuk duhet të pranohet si e papajtueshme me dispozitat e ligjit, për arsyet e mëposhtme:

Ankuesi A. K., pretendon se Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka shkelur detyrimet ligjore duke lejuar (ose duke mos ndërhyrë) ndërprerjen e aksesit të tij në sistemin SMIP, akses të cilin e kishte gjatë vitit shkollor 2024–2025, duke e trajtuar kështu në mënyrë diskriminuese si prind i divorcuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

- Ankuesi A. K., dhe znj. R. D., (K.) kanë lidhur martesë ligjore më datë 25.09.2017 dhe nga kjo martesë ka lindur vajza e tyre E. K., e datëlindjes 01.12.2017.
- Me vendimin nr. 14, datë 16.01.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim nënës, detyrimin e ankuesit për pagesën e pensionit ushqimor, si dhe ka njohur të drejtën e tij për takime periodike me fëmijën.
- Vendimi i shkallës së parë është apeluar dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 581 (30-2025-4760), datë 02.06.2025, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, duke shtuar të drejtën e ankuesit për komunikim elektronik me fëmijën dhe për takime gjatë pushimeve dimërore.
- Vajza e ankuesit, E. K., është nxënëse pranë Shkollës 9-vjeçare “Vëllazërimi” (Vartëse), Babrru – Kodër Paskuqan, në klasën e dytë.
- Gjatë vitit shkollor 2024–2025 ankuesi ka pasur akses në sistemin SMIP, nëpërmjet të cilit informohej mbi notat, mungesat dhe ecurinë shkollore të fëmijës.
- Në fillim të muajit tetor 2025 ankuesi ka konstatuar se nuk kishte më akses në sistemin SMIP për vitin shkollor 2025–2026.
- Më datë 05.12.2025 ankuesi i është drejtuar me *e-mail* ZVA Kamëz, duke kërkuar zgjidhje lidhur me mungesën e aksesit në SMIP, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje zyrtare.
- Më datë 04.02.2026 ankuesi i është drejtuar me kërkesë për informacion Shkollës 9-vjeçare “Vëllazërimi” (Vartëse), duke kërkuar sqarimin e arsyeve të ndërprerjes së aksesit në SMIP dhe rivendosjen e tij, pa marrë përgjigje lidhur me këtë kërkesë.
- Në të njëjtën datë, 04.02.2026, e njëjta kërkesë i është dërguar edhe ZVA Kamëz nëpërmjet postës elektronike, pa marrë përgjigje zyrtare.
- Më datë 05.02.2026 shkolla i ka dërguar ankuesit një informacion të kufizuar lidhur me gjendjen psikologjike-emocionale të fëmijës, pa përfshirë të dhëna mbi notat, mungesat apo komentet e mësueses.
- Më datë 16.04.2026 ankuesi i është drejtuar përsëri shkollës me kërkesë për informacion mbi arsyet teknike apo administrative të ndërprerjes së aksesit në SMIP dhe për rikthimin e tij.
- Më datë 16.04.2026 ankuesi ka paraqitur ankesa pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë. (*Referuar fotokopjes së lajmërim marrjes së Zyrës Postare*)
- Më datë 17.04.2026 ankuesi ka paraqitur një tjetër ankesë pranë shkollës, duke kundërshtuar pretendimet e saj dhe duke kërkuar ndalimin e diskriminimit.
- Më datë 20.04.2026 shkolla ka kthyer përgjigje, duke kundërshtuar pretendimet e ankuesit dhe pa marrë masa për rikthimin e aksesit në SMIP.

Ankuesi pretendon se pengimi i aksesit në sistemin SMIP dhe mungesa e informimit mbi arsimimin e fëmijës lidhen me statusin e tij si prind i divorcuar dhe përbëjnë diskriminim për shkak të përgjegjësisë prindërore, gjendjes familjare, gjendjes martesore dhe gjendjes civile.

Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010 “*Për bazat e të dhënave shtetërore*” është korniza themelore mbi bazën e të cilës funksionon sistemi SMIP. Ky ligj përcakton rregullat bazë për krijimin, administrimin e bazave të të dhënave shtetërore dhe ndërveprimin ndërmjet tyre, për të siguruar përdorimin me efektivitet, për interesa dhe shërbime publike, nga çdo subjekt i interesuar.

Mbi bazën e ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 3.12.2021 “*Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP)*”, i cili është akti i krijimit të SMIP-it dhe rregullon drejtpërdrejt aksesin dhe detyrimet institucionale. Pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 742, datë 3.12.2021 parashikon se institucioni administrues i bazës SMIP është Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Rregullorja “*Për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar*”, e miratuar me urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023 të Zëvendësministres së Arsimit dhe Sportit, është akti operacional që specifikon kompetencat e çdo institucioni brenda sistemit SMIP.

Neni 1 i Rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar, e miratuar me urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023, parashikon se objekti i saj është përcaktimi i rregullave për përdorimin e teknologjive të reja në sistemin arsimor parauniversitar sipas roleve të përcaktuara për subjektet për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) dhe përdoruesit e tij. Kjo dispozitë konfirmon se rolet dhe kompetencat janë fikse dhe nuk mund të ndryshohen me veprime të njëanshme të institucioneve.

Neni 6 i rregullores për përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar, e miratuar me urdhrin nr. 589, datë 16.10.2023, parashikon detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë. Sipas kësaj dispozite, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar ushtron përgjegjësitë si më poshtë: *koordinon punën me ZVAP-të dhe me institucionet arsimore për plotësimin në kohë dhe me saktësi të kurrikulave të shkollave dhe krijimin e klasave, duke përfshirë listën emërore përfundimtare të nxënësve të çdo klase; zbaton afatet e përcaktuara në kalendarin vjetor të DPAP-së për plotësimin e SMIP-it, për të gjitha fazat e vitit shkollor; koordinon punën me SuportSMIP dhe DPAP-në për problematika teknike të sistemit, të cilat janë bërë pengesë për punën e institucioneve arsimore parauniversitare në juridiksionin e ZVAP-ve që ka në varësi...*

Referuar kuadrit ligjor në fuqi për administrimin dhe funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), rezulton se Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë nuk ka kompetenca ligjore në lidhje me administrimin, dhënien, ndërprerjen apo rivendosjen e aksesit të prindërve në sistem. Sipas legjislacionit përkatës, përgjegjësitë për administrimin dhe menaxhimin e sistemit SMIP u janë ngarkuar institucioneve të përcaktuara shprehimisht nga aktet

ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa DRAP Tiranë, nuk rezultojnë të ketë rol vendimmarrës apo përgjegjësi të drejtpërdrejtë në këtë proces. Për rrjedhojë, pretendimet dhe kërkesat lidhur me aksesin në SMIP nuk gjejnë mbështetje juridike për t'u adresuar ndaj këtij institucioni.

Për rrjedhojë, për sa kohë legjislacioni në fuqi nuk i njeh Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, kompetenca për dhënien, ndërprerjen apo rivendosjen e aksesit të prindërve në sistemin SMIP, ky institucion nuk mund të konsiderohet subjekt përgjegjës për pretendimet e ngritura nga ankuesi lidhur me kufizimin e aksesit në sistem. Në këto kushte, pretendimet dhe kërkesat e ankuesit ndaj DRAP, nuk gjejnë mbështetje juridike në kuadrin ligjor që rregullon administrimin dhe përdorimin e sistemit SMIP.

Lidhur me pretendimin e ankuesit ndaj Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, në lidhje me ankesën e tij drejtuar këtij institucioni, rezultojnë se ankesa administrative pranë këtij institucioni është paraqitur më datë 16.04.2026, ndërsa ankesa objekt shqyrtimi drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar në datën 23.04.2026. Në këto kushte, rezultojnë se nuk ka kaluar një afat i arsyeshëm kohor që t'i mundësonte institucionit administrativ shqyrtimin e plotë të ankesës dhe kthimin e një përgjigjeje zyrtare, në ushtrim dhe përmbushje të kompetencave të tij monitoruese. Për rrjedhojë, vetëm fakti i moskthimit të një përgjigjeje brenda një periudhe kaq të shkurtër kohore nuk është i mjaftueshëm për të provuar, në vetvete, ekzistencën e një trajtimi diskriminues nga ana e DRAP.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa nr. 101, datë 23.04.2026 e paraqitur nga pala ankuese A. K., kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, nuk duhet të pranohet për t'iu nënshtruar procedurave të mëtejshme për shqyrtimin e saj, pasi nuk konstatohet që nga ana e DRAP të jenë konsumuar sjellje diskriminuese me veprime ose mosveprime dhe rrjedhimisht ankesa është haptazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 1 dhe pika 4, gërma “ç”, nenin 33 pika 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës me nr.101 Regj., datë 23.04.2026”, të z. A. K., kundër Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “përgjegjësisë prindërore”, “gjendjes familjare”, “gjendjes martesore” dhe “gjendjes civile”, pa një vendim përfundimtar për çështjen, për arsye se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)